



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E SHENDETESISE
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT SPITALOR
PROJEKTI BESSY

Bulevardi "Bajram Curri", Tirana, Albania

tel/fax 00355 4 3 64614

Nr. 8 Prot.

Tiranë, më 2/11/ 2012

FTESE PER NEGOCIM

Për : -----

Projekti BESSY ("Blood Ethical Good for Social Capital And Safety), prane Drejtorise se Planifikimit Spitalor ne Ministrine e Shendetesise ne kuader te implementimit te aktivitetete te tij, kerkon te realizoje procedure per perzgjedhjen e nje eksperti per komponentin WP6 te projektit BESSY

Fondi limit i vene ne dispozicion nga buxheti i projektit per ekspert te komponentit WP6 eshte 3500 Euro.

Lloji i procedurës së prokurimit të jetë : **Me negociim**

Kohëzgjatja e kontratës ose koha limit për përfundimin e saj eshte 31 korrik 2013 sipas kerkesave te vendosura ne kontrate.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë prane projektit BESSY, ne Drejtorine e Planifikimit Spitalor, Ministria e Shendetesise dokumentacionin e kerkuar.

Afati kohor për dorezimin e dokumentacionit është Data 16.11.2012, ora: 12.00 PM ne adresen : Projekti BESSY, Drejtoria E Planifikimit Spitalor, Ministria e Shendetesise, Bulevardi Bajram Curri, No.1, ne protokollin e Minisrise se Shendetesise.

Jemi në pritje të dokumentacionit tuaj.



I. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Dokumentacion, duhet te futet ne nje zarf jo transparent dhe duhet te permbaje dokumentat e kekruar.

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT

Pranimi i kandidateve do te behet ne bazuar ne dokumentacionin e dorezuar dhe intervisten gojore. Intervista gojore me kandidatin do te zhvillohet ne daten 16.11.2012 ora 14⁰⁰ ne Ministrine e Shendetesise.

2. TERMAT E REFERENCES

Qellimi i komponentit WP6 te projektit eshte krijimi I kompetence network midis vendeve te Adriatik te perfshira ne kete projekti pas perfundimit te ketij projekti, midis institucioneve shendetesore dhe NGO te perfshira ne promovimin dhe dhurimin vullnetare pa pagese te gjakut.

Eksperti do te ofroje asistence teknike per realizimin e aktiviteteve te ketij komponenti ne fund te te cilit do te rezultoj me pergatitjen e 4 dokumentave te rendesishme qe jane :

- a) Marreveshja e bashkepunimit midis partnereve te perfshire ne project(Adriatic Blood Network)
- b) Strategjia rajone e bashkepunimit midis vendeve te networkut
- c) Parimet etike te kartes se dhuruesit vullnetare te gjakut
- d) Libri i rekomandimeve per politikberesit

Kriteret e pergjithshme

- Profesionist i sistemin shendetesor me experience pune mbi 5 vjet ne shendetesi.
- Te kete patur eksperience te meparshme ne hartimin dhe pergatitjen e dokumentave strategjik ne fushen e shendetit
- Njohuri te mira mbi sistemin shendetesor shqiptar
- Njohuri te mira te gjuhes angleze
- preferohen kandidate qe kane eksperience ne projekte te meparshme ne fushen e shendetesise

Per kete Kandidati duhet të dorëzojë:

1. leter interesi me shkrim per pjesmarjen ne negocim
2. diplome e fakultetit
3. CV
4. Te pakten nje reference
5. Autodeklarate qe nuk eshte ne konflikt interesi dhe nuk ndiqet penalisht
6. oferta financiare



3. KUSHTET E PERGJITSHME TE KONTRATES

1. Eksperti do te asistojë ne mbledhjet e grupit te punes te ngritur per WP 6. Asistenca teknike do te realizohet duke :
 - a) Asistuar grupin e punes te ngritur per WP6 te projektit BESSY, ne procesin e formulimit te draftit fillestar te dokumentave qe do te pergatiten gjate ketij komponenti duke u bazuar ne :
 - rezultatet e analizës se bere legjislacionit shendetesore , organizimin e sistemit shendetesor dhe atij te transfuzionit, situaten e mbledhjes se gjakut dhe rolin e organizatave te perfshire ne dhurimin e gjakut, per vendet partnere te perfshira ne projekt.
 - rekomandimet WHO dhe EC ne fushen e dhurimit te gjakut dhe sistemin shendetesor.
 - karten Europiane e te drejtave te njeriut,
 - karta e te drejtave te pacientit
 - Resolution no. 23 World Health Organization, 1970
 - Guide for WHO collaborating centres
 - Legjislacion European dhe ate vendas qe lidhet me dokumentat qe do te pergatiten.
 - b) Shperndarja dhe diskutimi i draftit te pare me grupin e punes.
 - c) Mbledhja dhe pasqyrimi ne draft i kometeteve te mbledhura dhe pergatitja e draftit per tu paraqitur ne mbledhjet e komitetit teknik .
 - d) rishikimi i kometeteve dhe rekomandimeve te komitetit teknik te projektit (perfaqesues nga te gjith, partneret) te paraqitur ne mbledhjet e komitetit teknik te projektit per cdo dokument.
 - e) Pasqyrimi i kometeteve dhe rekomandime ne draft dhe diskutimi me grupin e punes per WP6
 - f) perfshiraj e te gjitha kometeteve dhe rekomandimeve dhe pergatitja e draftit final.
 - g) te pergatish dhe dorezohj draftin final per te dokumentate te perqatitur grupit te punes per WP6 .
 - h) Paraqitja e ketyre dokumentave per miratim komitetit teknik te projektit dhe pasqyrimi i veretjave apo rekomandimeve shtese nese ka nga ky komitet.
2. Respektimi i afateve kohore ne perqatitjen e materialve.
3. Te siguroj kontakte te vazhdueshme me kryetarin e grupit te punes per te siguruar pjesmarjen ne takimet me anetaret e grupit te punes si dhe ne takimet qe do te organizohj grupi pune.
4. Eksperti do te zhvilloj aktivitetin e tij ne autonomi te plote organizative dhe pa orar te paracaktuar, jashte ambienteve te punes se projektit. Nese e ka te nevojshme eksperti mund te shfrytezoj ambienteve te punes dhe sistemin kompjuterik te projektit me qellim permbyshtjen e detyres se tij sipas kerkesave te projektit.
5. Materialet ne formen perfundimtare duhet te jene gati ne fund te muajit qershor 2013. materiali do te dorezohet kordinatorit lokal te projektit ne hard kopi dhe ne forme elektronike (CD ose USB) ne gjuhen angleze.
6. PAGESA do te kryhet pas dorezimit te dokumentat ne formen perfundimtare dhe pasi te behet levrimi i fondit te caktuar nga projekti (fondi i BE). PAGESA do te behet njeheresh ose me dy keste ne perputhje me fondin e vene ne dispozicion.
7. PAGESA do te behet e urdher xhirimi ne llogarine personale ne banke ne euro ose leke sipas kursit te dites te shpalluar ne faqen e komisionit european kur do behet pagesa.

Kontrata do te lidhet me individet qe jane perzgjedhur nga komisioni i vleresimit bazuar ne kriteret e percaktuara ne kete dokumentacion. Vleresimi do behet me pike si me poshte :

1. Metodologjia 80 pike
2. Cmimi 20 pike

Te interesuarit duhet te dorezojne dokumentacionin e kerkuar me siper te futur ne nje zarf jotransparent te mbyllur me emrin e individit te ftuar . Brenda ketij zarfi duhet te paraqiten nje zarf me dokuemntacionin e pergjithshem kualifikues, nje zarf me oferten financiare.

Afati kohor per dorezimin e ofertave, si dhe per zhvillimin e negocimit ne lidhje me proceduren me objekt : **Perzgjedhja e ekspertit per komponenti WP6 te projektit Bessy** eshte me dt. **16.11.2012, ora 12.00**, ne zyren e protokollit me adrese : Drejtoria e Planifikimit Spitalor, Projekti BESSY, Ministria e Shendetesise, Bulevardi Bajram Curri, No.1 Tirane.

Mos e hapni zarfin me perjashtim te rasteve kur eshte i pranishem Komisioni dhe jo para dt. 16/11 /2012 ,ora 12.00. Per informacione te metejshme ose per paqartesi ju lutem kontaktoni ne adresen e kontaktit: vjollca.durro@moh.gov.al

Adresa : Drejtoria E Planifikimit Spitalor, Projekti BESSY, Ministria e Shendetesise, Bulevardi Bajram Curri, No.1

